



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:273958

Datë: 07.12.2023

Numri i dokumentit: 05027163

C-III.-12-1763

Paditësit - Propozuesit:

K N e R I që të gjithë nga K.Lipjan, të cilët i përfaqëson me autorizim N H avokate nga Prishtina.

Kundër:

E paditur – Pala kundërshtare:

NSH “Kooperativa Bujqësore – Kosova” – Lipjan, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë –Prishtinë,

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese, Manushe Karaqi dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.04 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Kërkesa për Masë të Sigurimit, refuzohet si e pabazuar**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.30 qershor 2006, i autorizuari i paditësve në Gjykatën Komunale në Lipjan ka paraqitur padi kundër të paditurës Kooperativa Bujqësore “Kosova” – Lipjan, me objekt të kontestit kompensim dhe dorëzim në posedim të paluajtshmërisë. Paditësit kanë pohuar se në bazë të aktgjykimit të formës së prerë C.nr.582/94 dt.26.10.2006 të Gjykatës Komunale në Lipjan

është anuluar kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur në mes të babait të paditësve R I nga f.sh K dhe të paditurës e vërtetuar në këtë gjykatë V.r.nr.... dt..... dhe me të njëjtin i është kthyer në pronësi parcela kadastrale nr... në sipërfaqe prej 0.97.94 e evidentuar në fletën poseduese nr... ZK K. Paditësit në vitin 1999 kanë kërkuar që të hynë në pronësi por e paditura nuk e ka ekzekutuar aktgjykimin, kurse në bazë të një aktgjykimi tjetër të kësaj gjykate, ngastra kadastrale ka kalur në pronësi të Zh V dhe L S nga Lipjani, ndërsa paditësi në bazë të një marrëveshje gojore me Drejtorin e Këshillit Drejtues të të paditurës, ka hyrë në posedim të ngastrës kadastrale nr.... në sipërfaqe prej 0.21.20 ha dhe ngastrës kadastrale nr... në sipërfaqe prej 0.34.61 ha në ZK K Padisë ia ka bashkangjitur këto prova: Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan P.nr.582/94 dt.26.10.1995, Fletën poseduese nr... ZK K Fletën poseduese nr... ZK K

Me aktvendimin C.nr.314/06 dt.03.12.2007, kjo gjykatë e ka ndërprerë procedurën për shkak të hapjes së procedurës së falimentimit ndaj të paditurës, kurse me dt.04.10.2012 lëndën me të gjitha shkresat ia ka dërguar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Me dt.06 mars 2014, i autorizuari i paditësve ka paraqitur një padi të korigjuar me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësve dhe të Detyrohet e paditura që në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.528/94 dt.26.10.1995, në emër të kompensimit të paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 0.97.94 ha, të ngastrës kadastrale nr... ZK K, që t'ia kthej në posedim paditësve me 1/3 e pjesëve ideale të ngastrave të tjera dhe atë ngastrat kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 0.21.20 ha në vendin e quajtur "B D", ngastrën kadastrale nr... në sipërfaqe prej 0.34.61 ha dhe ngastrën kadastrale nr... në sipërfaqe prej 0.42.13 ha ZK S K.Graçanicë.

E paditura me dt.04 prill 2014, ka paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën ka pohuar se konsideron se DHPGJS nuk ka juridiksion për të përmbaruar vendimet e gjykatave të rregullta, duke u bazuar në nenin 4 të ligjit për DHPGJS. Një qëndrim të tillë e ka shprehur edhe Kolegji i Apelit në vendimet e tij. AKP po ashtu pohon se kërkesëpadia e paditësve që rrjedh nga aktgjykimi i cili është parashkruar në bazë të nenit 379 të LMD-së.

Përgjigje në mbrojtjen e të paditurës ka paraqitur i autorizuari i paditësit me dt.25 prill 2014, ndërsa, e paditura ka paraqitur kundërpërgjigje me dt.27 qershor 2014.

E autorizuara e palës paditëse me dt.13 nëntor 2023, ka paraqitur në gjykatë Propozim për Caktimin e Masës së Sigurisë, ku ka pohuar se baza juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë është aktgjykimi C.nr.528/94 dt.26.10.1995. Paditësit kanë rënë në dijeni se AKP ka rrezik që ta tjetërsoj pronën përmes privatizimit, shitjes ose dhënies me qera te palët e treta edhe pse paditësi ka prova që paluajtshmëria lëndore sipas aktgjykimit është pronë e paraardhësit – babait të tyre. Andaj, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese dhe evitimit të riparueshëm ka propozuar që të caktohet masa e sigurisë ashtu që ti ndalohej kundërshtares së sigurimit që të ndërmarr ndonjë veprim me të cilin do të mund të pengohet , dëmtohet apo të tjetërsohet ose të privatizohet objekti i sigurimit.

E paditura me dt.17 nëntor 2023 ka paraqitur përgjigje në kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, ku ka pohuar se në këtë çështje ekziston çështja paraprake në kuptim të nenit 13 të LPK, pasi që pala paditëse ka paraqitur kërkesë në AL për të njëjtën çështje dhe e njëjta i është refuzuar me vendimin PRN082-0434/2016 dt.30.06.2016. Kundër këtij vendimi pala ka

paraqitur ankesë në DHPGJS dhe është zhvilluar procedura në lëndën C-IV-14-4886. AKP konsideron se kërkesa për masë duhet të hedhet poshtë pasi që mungon legjitimiteti pasiv i të paditurës dhe i kundërshton në tërësi pretendimet si të pa bazuara në ligj dhe në dispozitat që e rregullojnë materien për vendosje të kërkesave për masa të sigurisë duke sqaruar se baza për caktimin e masës është neni 61 i Ligjit për DHPGJS. Provë ka bashkangjitur: Vendimin nr.PRN082-0434 dt.30.06.2016, Njoftimin e dërguar nga DHPGJS për AKP, Kopjen e ankesës së ankuesve kundër vendimit të AL.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për masë të sigurimit është e pabazuar.

Sipas nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cili kërkon urdhër paraprak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek paditësja, kështu që përveç që e njëjta duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Ekzistimi i së drejtës së pretenduar

Pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, Kolegji vlerëson se paditësit në këtë fazë të procedurës, nuk kanë dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tyre. Pretendimet e paditësve nuk mund të merren si provë për caktimin e masës së sigurisë. Mbi bazën e këtyre provave të dorëzuara nuk mund të konstatohet ekzistimi i të drejtës së tyre të pretenduar.

Aq më pak kur, në bazë të provave të cilat paditësit i kanë deponuar vërehet se lidhur me pretendimet e tyre janë udhëhequr disa procedura dhe asnjëra nuk ka marr një epilog përfundimtar. Pastaj Aktgjykimet e dorëzuara, listat poseduese dhe provat tjera tani për tani nuk flasin për ekzistimin e të drejtës së tyre mbi pronat kontestuese dhe paditësve nuk u jep të drejtë për të kërkuar caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata vlerëson se nuk është plotësuar as kushti për *dëm të menjëhershëm* për caktimin e Masës së sigurimit, pasi që paditësit nuk kanë paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritët të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe se nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

Sipas dispozitave ligjore dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Pra sipas kësaj fjalie edhe po t’i shkaktohej dëm paditësve i cilin pretendojnë se pa të drejtë u është marr prona, prapë ky dëm nuk do të ishte i pariparueshëm, pasi që atyre do tu kompensohej dëmi i shkakuar me anë të një kompensimi financiar. Në rastin konkret edhe kushti për dëm të pariparueshëm, si kusht për tu caktuar masa e sigurimit nuk është plotësuar.

Për më tepër gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dokumenteve të parashtruara nga paditësi dhe pretendimeve të parashtruara në padi gjeti se, paditësit kërkesën e tyre e orientojnë në kompenzim për parcelat: ashtu që sipërfaqen prej 0,097.94 ha, sipërfaqen e tërësishme të ngastrës kadastrale nr. ..në vendin e quajtur B D në sipërfaqe prej 0,21.20 ha , ngastrës kadastrale nr. ..në sipërfaqe prej 0,34.61 ha e evidentuar në emër të të paditurës në fletën poseduese nr. ..ZK K , K Lipjan dhe sipërfaqen prej 0,42.13 ha nga sipërfaqja e tërësishme e ngastrës kadastrale nr... ZK S..

Andaj pala duhet të ofrojë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të *menjëhershëm* dhe të *pariparueshëm financiarisht* nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga arsyet e mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur mbi padinë, gjykata konstaton se në këtë rast, paditësi nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonte lëshimin MS. Paditësi nuk ka parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rrezikut të dëmit dhe për më tepër të parashtrorë asnjë dëshmi e që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm do të shkaktohej në qoftë se Masa e Sigurimit nuk do të lëshohej.

Në këtë rast gjykata nuk ka gjetur se kërkesa për Masë të Sigurimit mund të ketë mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme prandaj, kërkesa si e tillë u refuzua.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Paditësi tani më ka paguar taksën gjyqësore për kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme Brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese

Manushe Karaqi, Gjyqtare

Diellza Hoxha, Gjyqtare